



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration



STRATEGJIA PËR VETËQEVERISJE LOKALE 2016-2026



PRISHTINË, 2015



Strategjia për Vetëqeverisje Lokale 2016-2026




Vizioni

Shërbime më të mira komunale, rritje e kualitetit të jetës së qytetarëve

Misioni

Të rritet autonomia lokale dhe të forcohet aftësia e Komunave, që nëpërmjet pjesëmarrjes aktive të qytetarëve dhe përfaqësimit demokratik, të ofrohen shërbime me kosto efektive dhe të përgjegjshme për të rritur cilësinë e jetës, sigurinë dhe ekonominë lokale.





OBJEKTIVAT STRATEGJIKE 10 VJEÇARE

Objektiva Strategjike 1.

Rritja e qëndrueshmërisë ekonomike dhe sociale e komunave për të siguruar që politikat zhvillimore dhe financiare të ndikojnë në zhvillimin ekonomik lokal.

Objektiva Strategjike 2

Krijimi i një kornize për qeverisje të mirë për të siguruar përfaqësimin demokratik të qytetarëve dhe administratë efektive komunale.

Objektiva Strategjike 3


Forcimi i kapaciteteve profesionale dhe institucionale të komunave për të arritur përmirësim të qëndrueshëm në shërbimet komunale për qytetarët

Objektivi Strategjik 4

Forcimi i partneriteteve ndërmjet pushtetit lokal, shoqërisë civile dhe bizneseve për të krijuar një qytetari aktive, gjithëpërfshirëse dhe kohezive

Objektivi Strategjik 5

Promovimi i vlerave të trashëgimisë dhe afirmimi i diversitetit kulturor, natyror dhe social me qëllim të zhvillimit socio-ekonomik të Komunave



Zgjidhjet e propozuara

Objektivi Strategjik 1

Rritja e qëndrueshmërisë ekonomike dhe sociale e komunave për të siguruar që politikat zhvillimore dhe financiare të ndikojnë në zhvillimin ekonomik lokal.

Rezultatet e pritura:

- Ndryshimi i sistemit financiar të Komunave;
- Ndarja proporcionale ndërmjet ndarjeve buxhetore;
- Mundësia e ofrimit të shërbimeve në partneritet me biznesin privat;
- Themelimi i ndërmarrje publike etj.
- T'iu mundësohet forma dhe modalitete bashkëkohore të financimit;
- T'iu garantohet me ligj komunave inkasimi i të hyrave sidomos për tatimin në pronë, në ndërlidhje me ofrimin e shërbimeve publike;
- Mundësia e përfitimit të fondeve qeveritare sipas një sistemi gjithëpërfshirës dhe jo-diskriminues.
- Mundësia e komunave për të marrë kredi me norma të ulëta të interesi;
- Zvogëlimin e TVSH-së në produkte dhe mundësimin e lehtësive për taksat dhe tatimet për bizneset lokale etj.



Strategjitë e veprimit

- Zhvillimi i politikave efektive për zhvillimin dhe qëndrueshmërinë ekonomike lokale;
- Krijimi i politikave zhvillimore që rrjedhin nga qeveria qendrore si dhe ndryshimi i bazës ligjore për financimin e Komunave;
- Ndërtimi i infrastrukturës së rrugëve lokale dhe rrjetit të transportit ndër-urban;
- Aftësimi i të rinjve, si fuqi punëtore;
- Mbështetja e biznese;
- Zhvillimi i sektorit të bujqësisë;

Objektivi Strategjik 2

Krijimi i një kornize për qeverisje të mirë për të siguruar përfaqësimin demokratik të qytetarëve dhe administratë efektive komunale.



Rezultatet e pritura:

- Avancimi dhe harmonizimi i sistemit të VQL me praktikën e BE;
- Legjislacioni për kompetencat e komunave në harmoni të plotë me BE;
- Zgjerimin e të drejtës zgjedhore edhe për qytetarët e vendeve tjera, me leje qëndrimi në komunën përkatëse
- Themelimi, ekzistimi apo shuarja e Komunave të ndërlidhet ngushtë me qëndrueshmërinë financiare dhe ekonomike të tyre;
- Forcimi i mekanizmave të kontrollit të publikut dhe qytetarëve ndaj punës së institucioneve lokale;
- Forcimi i mekanizmave të kontrollit dhe balancit ndër-institucional në Komuna;
- Forcimi i memories institucionale në kuadër të administratës lokale;
- Dyshkallshmëria në procesin administrativ brenda komunës;
- Modernizimi i administratës komunale;
- Ulja e numrit të njësive të VQL në përputhje me trendet e BE.

Strategjitë e veprimit

- Zhvillimi i politikave efektive për zhvillimin dhe qëndrueshmërinë ekonomike lokale;
- Krijimi i politikave zhvillimore që rrjedhin nga qeveria qendrore si dhe ndryshimi i bazës ligjore për financimin e Komunave;
- Ndërtimi i infrastrukturës së rrugëve lokale dhe rrjetit të transportit ndër-urban;
- Aftësimi i të rinjve, si fuqi punëtore;
- Mbështetja e biznese;
- Zhvillimi i sektorit të bujqësisë;

Objektivi Strategjik 3

Forcimi i kapaciteteve profesionale dhe institucionale të komunave për të arritur përmirësim të qëndrueshëm në shërbimet komunale për qytetarët



Rezultatet e pritura:

- Ndërtimi i një administrate profesionale dhe të përgjegjshme;
- Një qasje gjithëpërfshirëse në ngritjen e kapaciteteve të shërbyesve civil në Komuna. Të futet sistemi i kredive në procesin e trajnimit;
- Zbatimi i ligjshmërisë dhe rritja e llogaridhënies;
- Rritjen e kapaciteteve profesionale për të planifikuar dhe menaxhuar financat lokale;
- Shërbimet komunale të kenë cak qytetarin, bazuar në formulën e shërbimit ndaj klientit;
- Rritja e kapaciteteve për digjitalizimin e shërbimeve administrative;
- Rritja e kapaciteteve menaxhuese (planifik, organizim, komunikim, zbatim, vlerësim etj.);
- Rritja e pjesëmarrjes së qytetarëve në jetën publike;
- Rritja e kapaciteteve infrastrukturore për menaxhimin efektiv dhe efikas të shërbimeve publike;
- Rritja e kapaciteteve për të kontribuar në shërbimet për komunitetin
- Rritja e kapaciteteve menaxhuese për planifikimin hapësor (menaxhimin e tokës, pronës komunale, menaxhimin e burimeve natyrore dhe qëndrueshmërinë e mjedisit.

Strategjitë e veprimit

- Qasja gjithëpërfshirëse dhe e koordinuar e zhvillimin e kapaciteteve profesionale;
- Akademia për Vetëqeverisjen Lokale
- Përmirësimi i kapaciteteve komunale në nivelin individual;
- Përmirësimi i kapaciteteve institucionale të Komunës;
- Krijimi i strukturave shtetërore adekuate për zhvillimin e kapaciteteve;
- Institucionalizimit i mekanizmave efektivë për të angazhuar shoqërinë civile dhe sektorin privat në ofrimin e shërbimeve janë domosdoshmëri e kohës.
- Përkrahja e ndryshimit të sjelljes së punonjësve të administratës;

Objektivi Strategjik 4

Forcimi i partneriteteve ndërmjet pushtetit lokal, shoqërisë civile dhe bizneseve për të krijuar një qytetari aktive, gjithëpërfshirëse dhe kohezive



Rezultatet e pritura:

Angazhimi i kompanive private në ofrimin e shërbimeve komunale;
Përfshirja e sektorit joqeveritar – shoqërisë civile në monitorimin e punëve në komunë;
Ndarja e fondeve stimuluese për OJQ

Strategjitë e veprimit

- Rritja e vlerave demokratike përmes praktikave të involvimit qytetar;
- “Strategjitë lokale për involvimin qytetar”;
- Raportet qytetar-komunë të ngrihen në nivelin e partneritetit dhe qytetari të jetë një partneri kryesor i komunës.
- Ngritja e vetëdijes qytetare për kontributin në komunitet dhe kultivimi i ndjenjës së vullnetarizmit
- Hartimi i planeve për secilën shkollë fillore që do të ndikonte në kultivimin e ndjenjës së vullnetarizmit tek fëmijët.
- Krijimi i qendrave për përfshirje të qytetarëve dhe vullnetarizëm
- Hartojnë “planet për e të involvimin qytetar dhe vullnetarizmin.
- Fuqizimi i shoqërisë civile dhe bizneseve të reja
- “Programeve të auditimeve sociale”
- “Planet komunale për nxitjen e ndërmarrësve të rinj”

Objektivi Strategjik 5

Promovimi i vlerave të trashëgimisë dhe afirmimi i diversitetit kulturor, natyror dhe social me qëllim të zhvillimit socio-ekonomik të Komunave



Rezultatet e pritura:

- Nxitja dhe promovimi i diversitetit kulturor dhe natyror;
- Rritja e vetëdijes shoqërore për vlerat e diversiteti kulturor dhe natyror;
- Konservimi i trashëgimisë natyrore dhe kulturore;
- Restaurimi i objekteve të ndryshme me rëndësi të veçantë kulturore;
- Vetëdijesimi për benefitet që mund të ketë ekonomia lokale për shkak të nxitjes së turizmit kulturor dhe natyror

Strategjitë e veprimit

- Hartimi i planeve lokale për promovimin e trashëgimisë kulturore
- Integrimi në ueb-faqet zyrtare të komunave i databazës së fotografive për të gjithë trashëgiminë kulturore dhe natyrore, si dhe publikimi i kalendarit të ngjarjeve dhe aktiviteteve kulturore.
- Markimi i vendeve me rëndësi kulturore, i monumenteve historike, i fenomeneve natyrore të përfshihet në hartat turistike dhe secila komunë të hartojë "librat turistik" dhe "hartat e trashëgimisë kulturore dhe natyrore".
- Përdorimi i rrjeteve sociale është një nga mundësitë që sot ofron teknologjia për të promovuar diversitetin dhe trashëgiminë;
- Komunitat do të krijojnë regjistrin lokal që përfshijnë objekte dhe vende me rëndësi të trashëgimisë kulturore dhe natyrore në nivel lokal,
- Krijimi i një sistemi efektiv për monitorimin dhe regjistrimin e kushteve dhe gjendjes së objekteve të trashëgimisë kulturore
- Hartimi i planeve lokale për konservimin e objekteve të trashëgimisë kulturore.
- Krijimi i programeve lokale për promovimin e turizmit rural
- Promovimi i produkteve vendore dhe tradicionale; punës së dorës si dhe organizimin e panairëve të ndryshme me veshjet tradicionale dhe ushqimet tradicionale, sipas një kalendarit të aktiviteteve të rregullta

Obligimet kryesore të përbashkëta

- Vlerësimi dhe Harmonizimi i legjislacionit të brendshëm;
- Harmonizimi i legjislacionit me acquis të BE-së;
- Harmonizimi i legjislacionit sekondar me legjislacionin e brendshëm dhe acquis;
- Qartësimi dhe shkallëzimi horizontal i kompetencave të komunave sipas potencialit dhe kapaciteteve;
- Krijimi i mekanizmave të plotë ligjor dhe administrativ për mbikëqyrje efektive në mbrojtjen e ligjshmërisë gjatë punës së komunave;
- Hartimi i Strategjisë për zhvillimin ekonomik lokal;
- Përmirësimin e kornizës ligjore dhe ndryshimin e sistemit të financimit të komunave;
- Krijimi i politikave për fuqizimin e kapaciteteve menaxhuese financiare dhe ekonomike të zyrtareve lokal të komunave;
- Mbështetjen për bizneset dhe bujqit për të zgjeruar veprimtarinë e tyre si në tregun kombëtar edhe në atë ndërkombëtar;
- Ndërtimi i kapaciteteve të komunave që të menaxhojë resurset natyrore për të krijuar qëndrueshmëri shoqërore dhe ekonomike lokale;
- Përmirësimi dhe ndërtimi i rrugëve rurale;
- Hartimin e programeve të veçanta trajnuese për të rinjtë;
- Krijimin e skemave të kredive me kamata të ulëta për komunitat;
- Hartimin e skemave programore për punësim në sektorin e bujqësisë;
- Krijimin e mekanizmave për stimulimin e bizneseve dhe produkteve vendore ;
- Mbështetjen e të rinjve dhe grave në biznes përmes kreditimit të aktiviteteve të tyre;
- Hartimin dhe zbatimin e politikave për nxitjen e pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje;
- Zhvillimin e mekanizmave institucional për përfshirjen e shoqërisë civile në ofrimin e shërbimeve;
- Hartimin e planeve për përfshirjen e qytetarëve në punë vullnetare në kuadër të lagjeve urbane dhe rurale;
- Themelimin e "Akademisë për Vetëqeverisjen Lokale" Hartimin e programeve të integruara të trajnimit në fushën e administratës publike dhe qeverisjes së mirë për zhvillim të kapaciteteve profesionale të stafit të komunave;
- Promovimi i trashëgimisë kulturore në funksion të zhvillimit ekonomik lokal,



PLANI I VEPRIMIT

Zbërthimi i të gjitha veprimeve kryesore për zbatimin e strategjisë do të bëhet nëpërmjet këtij plani të veprimit, i cili është pjesë përbërse e Strategjisë së VQL 2016-2026.

Plani i veprimit është hartuar për një periudhë tre vjecare (2016-2018). Sipas objektivave të strategjisë janë listuar aktivitetet konkrete, përgjegjësit, buxheti dhe afatet kohore për realizimin e këtyre objektivave.

Hapat për zbatimin e strategjisë



Rekomandimet për zgjidhjen e problemeve;
Përcaktimi i përgjegjësave;

Ekipi Qendror për Zbatimin e Strategjisë (EQZS)
Ekipe të Komunave për Zbatimin e Strategjisë (EKZS)

Zhvillimi dhe zbatimi i punëve;
Monitorimi dhe vlerësimi;
Rishikimi;
Përcaktimi i shpenzimeve dhe burimi i tyre;



STRATEGJIA PËR VETËQEVERISJE LOKALE 2016-2020



Kontakti

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Adresa: Ish ndërtesa e Rilindjes Katet: 10, 11, 12 dhe 13 Prishtinë, Republika e Kosovës
+381 (0) 200 35 630 (central)